FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 149 — 22 nëntor — 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 743, datë 16.10.2012	Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese”……	8169

VENDIM
Nr. 743, datë 16.10.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MBROJTJEN E PUBLIKUT NGA RREZATIMET JOJONIZUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 10 469, datë 13.10.2011 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR MBROJTJEN E PUBLIKUT NGA RREZATIMET JOJONIZUESE

1. Qëllimi

1.1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e rregullave për sigurimin dhe mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese.

2. Objekti

2.Kjo rregullore përcakton:

2.1 Kufijtë e ekspozimit dhe kufizimet bazë të ekspozimit në rrezatimet jojonizuese, sipas aneksit që i bashkëngjitet kësaj rregulloreje.

2.2 Kriteret e posaçme që duhet të plotësojnë personat fizikë dhe juridikë për t'u pajisur me akt miratimi për të ushtruar veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues.

2.3 Procedurat për lëshimin e aktit të miratimit të veprimtarisë me burime të rrezatimit jojonizues të personave fizikë dhe juridikë.

2.4 Afatet e shqyrtimit të aplikimit të personave fizikë dhe juridikë dhe të vendimmarrjes për akt miratimin e kërkuar.

2.5 Mënyrën e inspektimit dhe të kontrollit të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me mbrojtjen nga rrezatimi jojonizues nga ana e subjekteve.

3. Përjashtimet

3.1 Bëjnë përjashtim nga zbatimi i kësaj rregulloreje të gjitha burimet e rrezatimit jojonizues, të cilat nuk kanë efekt për publikun, siç e përcakton KMR-ja.

3.2 Bëjnë përjashtim nga zbatimi i kësaj rregulloreje të gjitha burimet natyrale të rrezatimit jojonizues.

4. Kriteret dhe procedurat për pajisjen me akt miratimi për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues

4.1 Çdo person fizik ose juridik, që ushtron veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues, është i detyruar të pajiset me akt miratimi nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi, i cili është i përhershëm për sa kohë nuk ka modifikime apo ndryshime të fushës elektromagnetike të gjeneruar.

4.2. Për pajisjen me akt miratimi për të ushtruar veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues personat fizikë dhe juridikë duhet të përmbushin këto kritere:

4.2.1 Të jenë të pajisur me ekstraktin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve si person fizik ose juridik.

4.2.2 Të jenë të pajisur me certifikatën e konformitetit, për pajisjet që do të instalohen, lëshuar nga autoriteti përkatës dhe i njohur në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi.

4.2.3 Të jenë të pajisur me vlerësimin për shpërndarjen e rrezatimit nga ekspertë të mbrojtjes nga rrezatimi të njohur nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për çdo burim ose grup burimesh në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese.

4.3 Për pajisjen me akt miratimi, personi fizik/juridik duhet t'i drejtohet Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi, i cili vendos për lëshimin e aktit të miratimit jo më vonë se 30 ditë pune nga aplikimi fillestar. Kërkesa bëhet nëpërmjet aplikimit për akt miratimi në Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimi sipas formularit bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

4.4 Nëpërmjet inspektorëve të saj, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi bën shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit të paraqitur, kërkon dokumente shtesë kur informacioni nuk është i plotë ose bën verifikimin në terren të të dhënave, kur e sheh të arsyeshme. Inspektorët përgatisin një dokument shoqërues, bazuar në vlerësimin e dorëzuar nga personi fizik/juridik, i cili merr në konsideratë sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese.

4.5 Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi shqyrton aplikimin, nëse janë përmbushur ose jo kriteret për pajisjen e subjektit me akt miratimi. Pas shqyrtimit nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi, aplikimi dërgohet në Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimi për miratim. Mbrojtja nga rrezatimet jojonizuese dhe siguria e dhënë nga ekspertiza mbetet përgjegjësi e plotë e aplikantit dhe e ekspertit.

4.6 Në instalimin e burimeve të reja personat fizikë/juridikë marrin në konsideratë dhe shpërndarjen e rrezatimit jojonizues të instalimeve ekzistuese. Në rast se një person fizik/juridik i ri synon të instalojë burime të reja në një pikë ku gjenden burime ekzistuese të tij ose personave fizikë/juridikë të tjerë, atëherë burimet e reja duhet të gjenerojnë rrezatim deri në diferencën midis kufirit të lejuar dhe shumatores së burimeve ekzistuese. Në rastin kur personat fizikë/juridikë janë ekzistues dhe shumatorja e burimeve të instaluara e kalon kufirin, atëherë të gjithë personat fizikë/juridikë ulin fuqitë e burimeve në nivel të barabartë të ponderuar, në mënyrë që të gjithë personat fizikë/juridikë së bashku të respektojnë limitet.

4.7 Për çdo aplikant mbahet një dosje pranë arkivit të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi. Ngarkohet Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi për plotësimin dhe mirëmbajtjen e arkivit.

4.8 Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi, pas miratimit nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi, përgatit akt miratimin për subjektin përkatës, sipas formatit të miratuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi.

4.9 Për çdo ndryshim në burim, që vjen si pasojë e ndryshimit teknologjik të shpërndarjes së rrezatimit, personi fizik/juridik duhet të kërkojë ndryshimin e aktit të miratimit dhe të paraqesë vlerësimin përkatës pranë Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi. Në këtë rast, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi vepron si në rastin e një aplikimi të ri. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi vendos për ndryshimin e aktit të miratimit jo më vonë se 30 ditë pune nga data e aplikimit si në rastin e një aplikimi të ri.

4.10 Tarifat për aplikimin për pajisjen me akt miratimi përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Shëndetësisë, duke qenë objektivë dhe duke marrë në konsideratë mbulimin e kostove administrative.

5. Inspektimi

5.1 Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, nëpërmjet inspektorëve të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi, kontrollon zbatimin e dispozitave që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimet e të gjitha veprimtarive të miratuara.

5.2 Inspektorët pajisen me dokument identifikimi, sipas legjislacionit në fuqi për inspektimet. Statusin e inspektorit të mbrojtjes nga rrezatimet e përfitojnë për shkak të detyrës punonjësit e Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi.

5.3 Të drejtat dhe detyrat e inspektorëve, si dhe procedura e inspektimit të subjekteve që kryejnë veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues, realizohen në përputhje me ligjin "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

6. Ndreqja e të metave nga subjekti

6.1 Gjatë ushtrimit të inspektimit, nëse inspektorët konstatojnë të meta në veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizues, i lënë detyra subjektit për ndreqjen e tyre brenda një afati 14 ditësh. Nëse edhe pas këtij afati subjekti nuk ka kryer detyrat e lëna inspektori nëpërmjet Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi, i propozon Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi revokimin e aktit të miratimit të veprimtarisë me burime të rrezatimit jojonizues.

7. Dispozita kalimtare

7.1 Për burimet e instaluara në funksionim përpara daljes së kësaj rregulloreje, duhet të fillojë aplikimi për t'u pajisur me akt miratimi brenda 6 muajsh nga hyrja në fuqi e saj. Operatorët që janë subjekt i kësaj dispozite, duhet të paraqesin një raport të plotë të ekspertëve për shpërndarjen e rrezatimit rreth burimit/ve për të gjitha instalimet që tashmë funksionojnë, së bashku me dokumentacionin që nevojitet, si në rastin e një aplikimi të ri.

7.2 Metodat e vlerësimit të shpërndarjes së rrezatimit jojonizues rreth stacioneve bazë përcaktohet me udhëzim të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi.

KËRKESË PËR AKT MIRATIMI
PËR VEPRIMTARINË E BURIMEVE TË RREZATIMEVE JOJONIZUESE

Aplikim i ri _____
Amendim i miratimit_____

1. Personi juridik/fizik: institucioni_____
Emri, mbiemri _____
Adresa_____
Adresa e stacionit _____
Tel._____
Faks _____
E-mail _____

Bashkëngjitur një kopje të regjistrimit të personit juridik/fizik, QKR

2. Përshkruani ambientet ku kryhet veprimtaria me rrezatime jojonizuese.

Paraqisni topografinë e instalimit dhe të shpërndarjes së rrezatimit jojonizues nga burimi për të cilin kërkohet aprovim. Të dhëna të sakta për parametrat teknikë të sistemit gjenerues. Studim për vlerësimin e shpërndarjes së rrezatimit jojonizues, nga ekspert i njohur nga KMR-ja.

Për sa më sipër, kërkoj lëshimin e aktit të miratimit për _____, duke mbajtur përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme.

Data _____ Nënshkrimi _____

I gjithë dokumentacioni të jetë në origjinal, i noterizuar ose me vulë lidhëse të institucionit tuaj.

Pas plotësimit me kujdes të rubrikave të këtij formulari, dërgojeni atë, së bashku me dokumentet e tjera të nevojshme, në adresën e mëposhtme:

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi
Instituti i Shëndetit Publik
Rr. "Aleksandër Moisiu", nr. 80
Tiranë

Dërgimi i një kërkese të paplotësuar në mënyrë të rregullt dhe të plotë do të sjellë vonesa, për të cilat përgjegjësia bie mbi aplikantin.

Data _____ Inspektori: emri, mbiemri, firma

_____

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi pasi analizoi kërkesën, aprovoi dhënien e aktit të miratimit.

Data_____ Sekretari i KMR-së

ANEKSI
PËR KUFIZIMIN E EKSPOZIMIT TË PUBLIKUT NDAJ FUSHAVE ELEKTROMAGNETIKE (0Hz – 300GHz)

Kjo aneks (shtojce) nuk i referohet mbrojtjes e punemarresve ne ekspozimin profesional ndaj fushave elektromagnetike.Ky aneks eshtë i domosdoshme për të mbrojtur publikun ne lidhje me efektet baze që mund të rezultojnë si pasojë e ekspozimit ndaj fushave elektromagnetike. Masat në lidhje me fushat elektromagnetike duhet tu sigurojne të gjithë qytetarëve të Komunitetit një nivel të lartë të mbrojtjes nga rrezatimet.

Kufizimet baze dhe nivelet e referencës duhet të zbatohen per të gjitha rrezatimet e emetuara nga fushat elektromagnetike me përjashtim të rrezatimit optik dhe rrezatimit jonizues. Për të vlerësuar përputhshmërinë me kufizimet bazë të parashikuara në këtë Shtojce, KMR njeh subjektet e autorizuara për të zbatuar standarde në pranimin dhe testimin e pajisjeve.(Certefikate Konformiteti). Respektimi i kufizimeve baze dhe të niveleve te referencës duhet të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes, në lidhje me efektet shëndetësore që mund të rezultojnë nga ekspozimi ndaj fushave elektromagnetike. KMR duhet të promovojë përhapjen e informacionit dhe rregullat në këtë fushë, në veçanti në lidhje me projektimin, instalimin dhe përdorimin e pajisjeve, në mënyrë që të synojë qe nivelet e ekspozimit te mos tejkalojnë kufizimet e dhena.

I duhet kushtuar vëmendje komunikimit dhe mirëkuptimit në lidhje me rreziqet per fushat elektromagnetike, duke marrë parasysh ndjeshmerine e publikut.Operatoret duhet te mbeshtesin dhe prezantojne fushata per mire informimin e publikut. KMR mer ne konsiderate progresin e bërë në njohurite shkencore dhe teknologjinë në lidhje me mbrojtjen ndaj rrezatimeve jojonizuese duke u mbeshtetur ne dokumentat INCIRP dhe OBSH dhe BE.

KMR siguron zbatimin dhe respektimin e kufizimeve bazë të dhënë në shtojcen II për ekspozim publik.

Gjithmone ne vleresimin e shperndarjes hapsinore te rrezatimit nga antena (Stacioni Baze), ose me konkretisht ne nxjerrjen e dimensioneve te zonave te kontrolluara, zbatohet parimi i mbrojtjes ne dozimetri , qe stacioni punon ne fuqi maksimale, ngarkese trafiku ne maksimum, perkulje te kombinuar elektrike/mekanike maksimale dhe natyrisht pa humbje ne transmetimin nga pajisja gjeneruse ne antene. Natyrisht ky skenar i rastit me te keq (sa i takon rrezatimit te prodhuar) mbivlereson dimensionet e zones se kontrolluar e cila ne perfundim rrit edhe marzhin e sigurise per te mbrojtur publikun nga efektet e mundshem te demshem te radiovaleve.

SHTOJCA I
PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj shtojce, termi "fushë elektromagnetike (FEM)" përfshin fushat statike, me frekuenca shumë të ulëta (FEFU), fushat dhe radiofrekuencat (RF), duke përfshirë mikrovalët, që shtrihen në diapazonin e frekuencave të 0 Hz deri 300 GHz.

A. Madhësitë fizike

Në kontekstin e ekspozimit EMF, tetë madhësitë fizike më të përdorura janë:

- Rryma e kontaktit (I_c) midis një personi dhe një objekti është shprehur në amper (A). Një objekt përçueshëm në një fushë elektrike mund të ngarkohet nga kjo fushë.

- Densiteti i rrymës (J) është përcaktuar si rrjedhja e rrymës në njësinë e seksionit të marrë pingul me drejtimin e lëvizjes së saj në një vëllim të përçueshëm, të tillë si trupi i njeriut ose pjesë e tij, shprehur në amper për metër katror (A/m^2).

- Intensiteti i Fushës elektrike është një madhësi vektoriale (E) e barabartë me forcën ushtruar mbi një grimcë të ngarkuar, pavarësisht nga lëvizja e saj në hapësirë. Ajo është e shprehur në volt për metër (V/m).

- Intensiteti i fushës magnetike është një madhësi vektoriale (H), e cila, së bashku me densitetin e fluksit magnetik, specifikon një fushë magnetike në çdo pikë të hapësirës. Ajo është e shprehur në amper për metër (A/m).

- Densiteti i fluksit magnetik është një madhësi vektoriale (B), në formën e një force që vepron mbi grimcat e ngarkuara në lëvizje dhe është shprehur në tesla (T). Në hapësirë dhe në materiale biologjike, densiteti i fluksit magnetik dhe intensiteti i fushës magnetike mund të llogariten duke përdorur ekuivalencën $A\ m^{-1} = 4\pi\ 10^{-7}$ T.

- Densiteti i fuqisë (S) është një madhësi e përshtatshme, e cila përdoret për frekuenca shumë të larta, ku thellësia e depërtimit në trup është e ulët. Kjo është fuqia e rrezatimit pingul në një sipërfaqe, pjesëtuar me sipërfaqen dhe është shprehur në vat për metër katror (W/m^2).

- Energjia specifike e përthithjes (SA) është përcaktuar si energjia e përthithur për njësinë e masës të indeve biologjike, e shprehur në *joules* për kilogram (J/kg). Në këtë shtojcë, ajo është përdorur për të kufizuar efektet jotermike nga rrezatimet e mikrovalëve pulsante.

- Fuqia e energjisë specifike të përthithjes (SAR), e mesatarizuar për të gjithë trupin ose për pjesët e trupit, është përcaktuar si fuqia e energjisë së përthithur për njësinë e masës të indit trupor dhe është shprehur në vat për kilogram (W/kg). Për gjithë trupin, SAR është e pranuar gjerësisht si matje, e cila lidh efektet e dëmshme termike me ekspozimet në RF. Përveç mesatarizimit për tërë trupin SAR, vlerat lokale janë SAR të nevojshme për të përcaktuar dhe për të kufizuar depozitimin e tepërt të energjisë në pjesë të vogla të trupit që rezultojnë nga ekspozime në kushte të veçanta. Shembuj të kushteve të tilla janë: një individ i ekspozuar ndaj RF-së me nivel të ulët MHz dhe individëve të ekspozuar në fushën afër një antene.

Këto madhësi, densiteti i fluksit magnetik, rryma e kontaktit, intensiteti i fushës elektrike dhe magnetike në terren dhe densiteti i fuqisë mund të matet direkt.

B. Kufizimet bazë dhe kufijtë e ekspozimit

Për zbatimin e kufizimeve të bazuara në vlerësimin e efekteve të mundshme shëndetësore të fushës elektromagnetike, duhet të bëhet dallimi në mes të kufizimeve bazë dhe niveleve të referencës.

Kufi ekspozimi ose nivelet e referencës. Këto nivele janë dhënë për vlerësim praktik të ekspozimit, me qëllim që të përcaktohet nëse kufizimet bazë tejkalohen ose jo. Disa nivele reference janë nxjerrë nga kufizimet bazë përkatëse, duke përdorur matje dhe/ose teknika llogaritëse dhe disa nivele reference, duke u bazuar në perceptimin dhe efektet e dëmshme indirekte të ekspozimeve ndaj fushave elektromagnetike (EMF). Madhësitë që rrjedhin janë: intensiteti i fushës elektrike (E), intensiteti i fushës magnetike (H), densiteti i fluksit magnetik (B), densiteti i fuqisë (S) dhe rrymën

në ekstremitete (IL). Madhësitë që bazohen në perceptimin dhe efekte të tjera të tërthorta janë rryma e kontaktit (IC) dhe për fushat pulsante, energjia specifike e përthithjes (SA). Respektimi i nivelit të referencës do të sigurojë respektimin e kufizimit bazë përkatës. Në qoftë se vlera e matur tejkalon nivelin e referencës, kjo nuk do të thotë që kufizimi bazë do të tejkalohet. Disa madhësi, të tilla si: fluksi i densitetit magnetik (B) dhe densiteti i fuqisë (S) shërbejnë si kufizime bazë dhe si nivele reference për disa frekuenca të caktuara (shih shtojcën II dhe III).

SHTOJCA II
KUFIZIMET BAZË

Në varësi të frekuencës, madhësitë e mëposhtme fizike janë përdorur për të specifikuar kufizimet bazë në fushat elektromagnetike:

- Midis 0 dhe 1 Hz, kufizimet bazë janë dhënë për densitetin e fluksit magnetik për fusha magnetike statike (0 Hz) dhe densitetin e rrymës për fusha të ndryshueshme deri në 1 Hz, me qëllim që të parandalojë efektet në sistemin nervor, qendror dhe kardiovaskular.
- Midis 1 dhe 10 MHz, kufizimet bazë janë dhënë për densitetin e rrymës për të parandaluar efektet në funksionet e sistemit nervor.
- Midis 100 kHz dhe 10 GHz, kufizimet bazë për SAR-in janë dhënë për të parandaluar stresin nga nxehja e tërë trupit dhe nxehjen e tepërt të indeve të lokalizuara. Në diapazonin 100 kHz deri në 10 MHz, janë dhënë kufizimet për densitetin e fuqisë dhe SAR.
- Midis 10 GHz dhe 300 GHz, kufizimet bazë për densitetin e fuqisë janë dhënë për të parandaluar nxehjen e indeve në ose pranë lëkurës.

Kufizimet bazë, dhënë në tabelën 1, janë vendosur në mënyrë që të marrin në konsideratë ndjeshmërinë individuale, kushtet mjedisore, si dhe për faktin që mosha dhe gjendja shëndetësore e publikut ndryshojnë në diapazon të gjerë.

TABELA 1
KUFIZIMET BAZË PËR FUSHAT ELEKTRIKE, MAGNETIKE DHE ELEKTROMAGNETIKE
(0Hz-300GHz)

Shkalla e frekuencave	**Densiteti i fluksit mag (mT)**	**Densiteti i rrymës (mA/m^2) (rms)**	**Mesatarizimi i gjithë trupit SAR (W/kg)**	**SAR lokal (koka dhe trungu) (W/kg)**	**SAR lokal (gjymtyrët) (W/kg)**	**Densiteti i fuqisë S (W/m^2)**
0Hz	40	-	-	-	-	-
＞0-1Hz	-	8	-	-	-	-
1-4 Hz	-	8/f	-	-	-	-
4-1000 Hz	-	2	-	-	-	-
1000Hz-100kHz	-	f/500	-	-	-	-
110kHz-10MHz	-	f/500	0.08	2	4	-
10MHz-10GHz	-	-	0.08	2	4	-
10-300GHz	-	-	-	-	-	10

Shënim

1. *f* është frekuenca në Hz.
2. Kufizimi bazë për densitetin e rrymës ka për qëllim të mbrojë ndaj efekteve të ekspozimit.
3. Për shkak të johomogjenitetit elektrik të trupit, densiteti i rrymës duhet të mesatarizohet në një prerje të sipërfaqes 1 cm^2 pingul me drejtimin e lëvizjes së rrymës.

4. Për frekuenca deri në 100 kHz, vlerat kulmore të densitetit të rrymës mund të merren duke shumëzuar vlerën RMS me $\sqrt{2} = (1{,}414)$. Për impulset me kohëzgjatje (tp) frekuenca ekuivalente që aplikohet në kufizimet bazë duhet të llogaritet si $f = 1/(2tp)$.

5. Për frekuenca deri në 100 kHz dhe për fusha magnetike pulsante, maksimumi i densitetit të rrymës që shoqëron impulset mund të llogaritet nga rritja/rënia e disahershme dhe nga maksimumi i fuqisë të ndryshimit të densitetit të fluksit magnetik. Densiteti i rrymës së induktuar mund të krahasohet me kufizimet e përshtatshme bazë.

6. Të gjitha vlerat SAR janë mesatarizuar për ndonjë periudhë gjashtëminutëshe.

SHTOJCA III
NIVELET E REFERENCËS

Nivelet e referencës të ekspozimit janë dhënë me qëllim krahasimi me vlerat e madhësive të matura. Respektimi i të gjitha niveleve të rekomanduara të referencës do të sigurojë respektimin e kufizimeve bazë.

Në qoftë se sasitë e vlerave të matura janë më të mëdha se nivelet e referencës, kjo nuk do të thotë që domosdoshmërish kufizimet bazë janë tejkaluar. Në këtë rast, duhet bërë një vlerësim për të treguar që nivelet e ekspozimit janë nën kufizimet bazë.

Nivelet e referencës për ekspozimin e kufizuar janë marrë nga kufizimet bazë për kushtin e bashkëveprimit maksimal të fushës me individin e ekspozuar, duke siguruar mbrojtje maksimale. Një përmbledhje e niveleve të referencës është dhënë në tabelat 2 dhe 3. Nivelet e referencës synojnë në përgjithësi të jenë vlera të mesatarizuara në të gjithë trupin e individit të ekspozuar, por me kushtin e rëndësishëm që kufizimet bazë lokale të ekspozimit nuk janë tejkaluar.

TABELA 2
NIVELET E REFERENCËS PËR FUSHAT ELEKTRIKE, MAGNETIKE DHE ELEKTROMAGNETIKE
(VLERAT E PAPERTURBUARA 0Hz DERI 300GHz)

Shkalla e frkuencave	**Fortësia e fushës elektrike – E (V/m)**	**Fortësia e fushës mag - H (A/m)**	**B- fushës (μT)**	**Densiteti i fuqisë së valës ekuivalente plane S_{eq} (W/m^2)**
0-1Hz	-	3.2×10^4	4×10^4	-
1-8Hz	10 000	$3.2 \times 10^4/f^2$	$4 \times 10^4/f^2$	-
8-25Hz	10 000	4 000/f	5 000/f	-
0.025-0.8KHz 0.8-	250/f	4/f	5/f	-
3kHz	250/f	5	6.25	-
3-150kHz	87	5	6.25	-
0.15-1MHz	87	0.73/f	0.92/f	-
1-10MHz	$87/f/^{1/2}$	0.73/f	0.92/f	-
10-400MHz	28	0.073	0.092	2
400-2000MHz	$1.375\ f^{1/2}$	$0.0037f^{1/2}$	$0.0046\ f^{1/2}$	f/200
2-500GHz	61	0.20	0.20	10

Shënim

1. f siç tregohet në shtyllën shkalla e frekuencave.

2. Për frekuenca midis 100 kHz dhe 10 GHz, S_{cq}, E^2, H^2 dhe B^2, do të mesatarizohet për çdo gjashtë minuta.

3. Për frekuenca më tepër se 10 GHz, S_{cq}, E^2, H^2 dhe B^2, do të mesatarizohet mbi çdo minutë $68/f^{1.05}$ (f në GHz).

4. Asnjë vlerë e fushës elektrike nuk është dhënë për frekuencat <1 Hz, të cilat janë efektivisht fushat elektrike statike. Për shumicën e njerëzve perceptimi i ngarkesave elektrike në sipërfaqe nuk do të ndodhë në fusha me fortësi më të vogël se 25 kV/m. Shkarkesat që shkaktojnë stres ose bezdi duhet të eliminohen.

Rrymat e kontaktit dhe rrymat në ekstremitete

Për frekuenca deri në 110 MHz, nivelet e referimit shtojcë janë rekomanduar në mënyrë që të shmangen rreziqet nga rrymat e kontaktit. Nivelet e referencës së rrymës së kontaktit janë paraqitur në tabelën 3. Nivelet e referencës në rrymën e kontaktit përcaktojnë faktin se pragu i rrymave të kontaktit që nxit reagimet biologjike të grave dhe të fëmijëve janë respektivisht dy të tretat dhe gjysma e atyre të burrave.

TABELA
NIVELET E REFERENCËS PËR RRYMAT E KONTAKTIT NGA OBJEKTET E PËRÇUESHME
(f NË KHz)

Shkalla e frekuencave	**Rryma e kontaktit max (mA)**
0 Hz-2.5 kHz 2.5 kHz-100 kHz 100 kHz-110 MHz	0.5 0.2 f 20

Për bandën e frekuencave 10 MHz deri 110 MHz, rekomandohet nivel referimi prej 45 mA për ndonjë gjymtyrë. Kjo ka për qëllim të kufizojë SAR lokal për çdo periudhë gjashtëminutëshe.

SHTOJCA IV
EKSPOZIMI NGA BURIMET ME SHUMË FREKUENCA

Në situata të ekspozimit të njëkohshëm në fusha me frekuenca të ndryshme, mundësisht ekspozimet të konsiderohen si shumatore për sa u përket efekteve të tyre. Llogaritjet e bazuara për shuma të tilla duhet të përcaktohen të ndara për çdo efekt. Ky vlerësim i ndarë duhet të bëhet për efektet e njëhershme termike dhe elektrike të stimuluara në trup.

Kufizimet bazë

Në rastet e ekspozimeve të njëhershme të fushave me frekuenca të ndryshme, kushtet e mëposhtme duhet t'u përmbahen termave të kufizimeve bazë.

Për stimulimet elektrike për frekuencat 1Hz, deri 10MHz densiteti i rrymës së induktuar duhet të shtohet në përputhje me:

$$\sum_{1=1\ Hz}^{10\ Mhz} \frac{J_i}{J_{L,i}} \leq 1$$

Për efektet termike nga 100 kHz, fuqia e energjisë specifike të përthithjes dhe densiteti i fuqisë duhet të shtohen në përputhje me:

$$\sum_{1\text{-}100\ kHz}^{10GHz} \frac{SAR_i}{SAR_L} + \sum_{i>\ 10\ GHz}^{300\ GHz} \frac{S_i}{S_L} \leq 1$$

ku:

Ji- është densiteti i rrymës për frekuencën "i".

$J_{L,i}$ - kufizimi bazë i densitetit të rrymës për frekuencën të dhënë në tab. 1.

SAR_i - është SAR i shkaktuar nga ekspozimi me frekuencë "i".

SAR_L - është kufizimi bazë i SAR dhënë në tab. 1.

S_i - densiteti i fuqisë në frekuencën "i".

S_L -kufizimi bazë i densitetit të fuqisë dhënë në tab. 1.

Nivelet e referencës

Për zbatimin e kufizimeve bazë, duhet të zbatohen kriteret e mëposhtme për sa u përket niveleve të dhe intensitetit të fushës. Për densitetin e rrymës së induktuar dhe efektet e stimuluara elektrike deri në 10 MHz, duhet të zbatohen dy kërkesat e mëposhtme për nivelet e fushës.

$$\sum_{i=1\ Hz}^{1\ MHz} \frac{E_i}{E_{L,i}} + \sum_{i>1\ MHz}^{10\ MHz} \frac{E_i}{a} \leq 1$$

dhe

$$\sum_{j=1\ Hz}^{150\ kHz} \frac{H_j}{H_{L,j}} + \sum_{j>150\ kHz}^{10\ MHz} \frac{H_j}{b} \leq 1$$

Ku:

Ei -Intensiteti i fushës elektrike për frekuencën "i".

E_L -niveli i referencës së intensitetit të fushës elektrike nga tab. 2.

Hj -Intensiteti i fushës magnetike në frekuencën "j".

H_L -niveli i referencës së intensitetit të fushës magnetike nga tab. 2.

a - është 87V/m dhe b është 5A/m (6.25μT).

Përdorimi i vlerave konstante ("a" dhe "b") mbi 1 MHz për fushat elektrike dhe mbi 150KHz për fushat magnetike mbështetet në faktin që mbledhja është bazuar në densitetin e rrymës së induktuar dhe nuk duhet të ngatërrohet me rrethanat e efekteve termike. Format e mëpasme, baza për E_L dhe H_L, mbi 1MHz dhe 150KHz përkatësisht janë dhënë në tab. 2.

Në rrethanat e efekteve termike nga 100kHz duhet të zbatohen dy kërkesat e mëposhtme për nivelet e fushës:

$$\sum_{i=100\ kHz}^{1\ MHz} \left(\frac{E_i}{c}\right)^2 + \sum_{i>1\ MHz}^{300\ GHz} \left(\frac{E_i}{E_{L,i}}\right)^2 \leq 1$$

$$\sum_{j=100\ kHz}^{150\ kHz} \left(\frac{H_j}{d}\right)^2 + \sum_{j>150\ kHz}^{300\ GHz} \left(\frac{H_j}{H_{L,j}}\right)^2 \leq 1$$

dhe ku:

Ei -Intensiteti i fushës elektrike për frekuencën "i".

E_L -niveli i referencës së intensitetit të fushës elektrike nga tab. 2.

Hj -Intensiteti i fushës magnetike në frekuencën "j".

H_L -niveli i referencës së intensitetit të fushës magnetike nga tab. 2.

C është $87/f^{1/2}$V/m dhe d 073/f A/m.

Për rrymat në gjymtyrë dhe rrymat e kontaktit, duhet të zbatohen respektivisht kërkesat e mëposhtme:

$$\sum_{k=10\ MHz}^{110\ MHz} \left(\frac{I_k}{I_{i,k}}\right)^{2 \leq 1} \sum_{n>1\ Hz}^{110\ MHz} \left(\frac{I_n}{I_{c,n}}\right)^2 \leq 1$$

ku:

I_k është komponentja e rrymës në gjymtyrë në frekuencën "k".

I_L është niveli referencës për rrymën në gjymtyrë 45mA.

In është komponentja e rrymës së kontaktit në frekuencën “n”.

Ic,n është niveli i referencës për rrymën e kontaktit në frekuencën (shih tab. 3).

Formula e mbledhjes së mësipërme përmbledh rastet më të këqija të rrethanave në mes të fushave nga burimet e shumëfishta. Si përfundim, situata të ekspozimit tipik, në praktikë, mund të rezultojnë më pak se vlerat kufi të ekspozimit të dhëna nga formulat e mësipërme të niveleve të referencës. Si rezultat, situatat e ekspozimit tipik në praktikë mund të rezultojnë më pak se vlerat e kufizimeve themelore të përcaktuara nga formulat e niveleve të referencës.

1. Numrin natyror, titullin e plotë dhe numrin në Fletoren Zyrtare të legjislacionit të BE-së që synohet të përafrohet nga projektakti, subjekti dhe objekti që synon të rregullojë ***31999H0519;*** *Council Recommendation of 12 July 1999 on the limitation of exposure of the general public to electromagnetic fields (0 Hz to 300 GHz);* OJ L 199, 30.7.1999, p. 59–70				
2. Titulli i projektaktit (aktit), subjekti dhe objekti që synon të rregullojë ***Projektvendim "Per miratimin e rregullores per mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojoznizuese "***				
3. Shkalla e përafrimit E plote				
a	b	c	d	e
Pjesët e legjislacionit të BE-së që përafrohen (neni, paragrafi, çështja) (në disa raste mund të përshkruhen citime dhe përmbledhje të *acquis*)	**Parashikimet e projektaktit (aktit) (titulli, seksioni, neni, paragrafi, çështja etj.)**	**Përputhja e projektaktit (aktit) me legjislacionin e BE-së (i plotë, i pjesshëm ose jo i aplikueshëm)**	**Arsyet për përputhje të pjesshme**	**Periudha e parashikuar për arritjen e përputhjes së plotë**
ANNEX I **DEFINITIONS** For the purposes of this recommendation, the term electromagnetic fields (EMF) includes static fields, extremely low frequency (ELF) fields and radiofrequency (RF) fields, including microwaves, encompassing the frequency range of 0 Hz to 300 GHz.	**SHTOJCA I** **PËRKUFIZIMET** Për qëllime të këtij rekomandimi, termi fushe elektromagnetike (FEM) përfshin fushat statike, me frekuenca shume të ulëta (ELF) fushat dhe radiofrequencat (RF) duke përfshirë mikrovalet, qe shtrihen ne diapazonin e frekuencave të 0 Hz deri300 GHz.	E plote		
A. Physical quantities In the context of EMF exposure, eight physical quantities are commonly used:	**A. Madhesite fizike** Në kontekstin e ekspozimit EMF, tetë madhesite fizike me te perdorura jane:	E plote		
Contact current (IC) between a person and an object is expressed in amperes (A). A conductive object in an electric field can be charged by the field.	**Rryma e kontaktit (I_c)** midis nje personi dhe një objekti është shprehur në Amper (A). Një objekt përçueshëm në një fushë elektrike mund të ngarkohet nga kjo fushë.	E plote		
Current density (J) is defined as the current flowing through a unit cross section	**Densiteti rrymes (J),** është përcaktuar si rrjedhja e rrymes ne njësine e seksionit te marre pingul me drejtimin e levizje se	E plote		

perpendicular to its direction in a volume conductor such as the human body or part of it, expressed in amperes per square metre (A/m2).	saj në një vëllimi te percueshem të tilla si trupi i njeriut, ose pjesë e tij, shprehur në Amper për metër katror (A/m^2).			
Electric field strength is a vector quantity (E) that corresponds to the force exerted on a charged particle regardless of its motion in space. It is expressed in volts per metre (V/m).	**Intensiteti i Fushes elektrike** është një madhesi vektoriale (E) e barabarte me forcën ushtruar mbi një grimcë të ngarkuar , pavarësisht nga lëvizja e saj në hapësirë. Ajo është e shprehur në volt për metër (V / m).	E plote		
Magnetic field strength is a vector quantity (H), which, together with the magnetic flux density, specifies a magnetic field at any point in space. It is expressed in amperes per metre (A/m).	**Intensiteti i fushes magnetike** është një madhesi vektoriale (H), e cila, së bashku me densitetin e fluksit magnetik, specifikon një fushë magnetike në çdo pikë të hapësirës. Ajo është e shprehur në Amper për metër (A / m).	E plote		
Magnetic flux density is a vector quantity (B), resulting in a force that acts on moving charges, it is expressed in teslas (T). In free space and in biological materials, magnetic flux density and magnetic field strength can be interchanged using the equivalence 1A m–1 = 4π 10–7 T.	**Densiteti i fluksit magnetik** është një madhesi vektoriale (B), ne formen e nje force që vepron mbi grimcat e ngarkuara ne lëvizje, dhe është shprehur në tesla (T). Në hapësirë dhe në materiale biologjike, densiteti i fluksit magnetik dhe intensitetie fushes magnetike mund te llogariten duke përdorur ekuivalencen A m^{-1}= 4π 10^{-7} T	E plote		
Power density (S) is the appropriate quantity used for very high frequencies, where the depth of penetration in the body is low. It is the radiant power incident perpendicular to a surface, divided by the area of the surface and is expressed in watts per square metre (W/m2).	**Densiteti i Fuqise (S)** është nje madhesi e pershtatshme e cila perdoret për frekuenca shumë të larta, ku thellësia e depërtimit në trup eshte e ulet . Kjo është fuqia e rrezatimit pingul në një sipërfaqe, pjestuar me sipërfaqen dhe është shprehur në wat për metër katror (W/m^2).	E plote		
Specific energy	**Energjia specifike e**	E plote		

absorption (SA) is defined as the energy absorbed per unit mass of biological tissue, expressed in joules per kilogram (J/kg). In this recommendation it is used for limiting non-thermal effects from pulsed microwave radiation.and advice	**perthithjes (SA)** eshte percaktuar si energjia e perthithur per njesine e mases të indeve biologjike, e shprehur në joules për kilogram (J / kg). Në këtë rekomandim ,ajo,është përdorur për të kufizuar efektet jo-termike nga rrezatimet e mikrovaleve pulsante.			
Specific energy absorption rate (SAR) averaged over the whole body or over parts of the body, is defined as the rate at which energy is absorbed per unit mass of body tissue and is expressed in watts per kilogram (W/kg). Whole body SAR is a widely accepted measure for relating adverse thermal effects to RF exposure. Besides the whole body average SAR, local SAR values are necessary to evaluate and limit excessive energy deposition in small parts of the body resulting from special exposure conditions. Examples of such conditions are: a grounded individual exposed to RF in the low MHz range and individuals exposed in the near field of an antenna. Of these quantities, magnetic flux density, contact current, electric and magnetic field strengths and power density can be measured directly	**Fuqia e energjise specifike te perthithjes (SAR)** e mesatarizuar per të gjithë trupin ose per pjesët e trupit, është përcaktuar si fuqiae energjise se perthithur per njesine e mase te indit trupor dhe është shprehur në vat për kilogram (W / kg). Per gjithe trupin SAR është e pranuar gjerësisht si matje e cila lidh efektet e demshme termik me ekspozimet ne RF. Përveç mesatarizimit per tërë trupit SAR, vlerat lokale janë SAR të nevojshme për të percaktuar dhe për të kufizuar depozitimin e tepert të energjisë në pjesë të vogla të trupit qe rezultojnë nga ekspozime ne kushtet të veçanta. Shembuj të kushteve të tilla janë: një individ i ekspozuar ndaj RF me nivel të ulët MHz dhe individëve të ekspozuar në fushën afër një antenë. Keto madhesi , densiteti i fluksit magnetik , rryma e kontaktit , intensiteti fushes elektrike dhe magnetike në terren dhe Densiteti i Fuqise mund të matet direkt	E plote		
B. Basic restrictions and reference levels For the application of restrictions based on the assessment of possible health effects of electromagnetic fields, differentiation should be	**B. Kufizimet baze dhe nivelet e referencës** Per zbatimin e kufizimeve te bazuara në vlerësimin e efekteve të mundshme shëndetësore të fushes elektromagnetike, duhet te behet dallimi në mes të	E plote		

made between basic restrictions and reference levels.	kufizimeve bazë dhe niveleve e referencës.			
Basic restrictions. Restrictions on exposure to time-varying electric, magnetic, and electromagnetic fields which are based directly on established health effects and biological considerations are termed 'basic restrictions'. Depending upon the frequency of the field, the physical quantities used to specify these restrictions are magnetic flux density (B), current density (J), specific energy absorption rate (SAR), and power density (S). Magnetic flux density and power density can be readily measured in exposed individuals.	**Kufizimet bazë**. Kufizimet ne ekspozime te fushave elektrike, magnetike, dhe elektromagnetike te ndryshueshme të cilat janë bazuar direkt mbi efektet shëndetësore te verfikuara dhe konsideratat biologjike janë quajtur "kufizime baze '. Ne varesi te frekuencave te fushës, madhesite fizike te përdorura për të specifikuar këto kufizime janë densiteti fluksit magnetike (B), densiteti i rrymes (J), Fuqia specifike e energjise se perthithjes (SAR), dhe Densiteti i Fuqise (S). Densiteti i fluksit magnetik, dhe densiteti i fuqise mund të maten lehtësisht në individë të ekspozuar.	E plote		
Reference levels. These levels are provided for practical exposure-assessment purposes to determine whether the basic restrictions are likely to be exceeded. Some reference levels are derived from relevant basic restrictions using measurements and/or computational techniques and some reference levels address perception and adverse indirect effects of exposure to EMFs. The derived quantities are electric field strength (E), magnetic field strength (H), magnetic flux density (B), power density (S), and limb current (IL). Quantities that address perception	**Nivelet e referencës**. Këto nivele janë dhënë për vleresim praktik te ekspozimit me qëllime për të përcaktuar nëse kufizimet bazë ka të ngjarë të jetë tejkaluar. Disa nivele reference janë nxjerrë nga kufizimet baze përkatëse duke përdorur matje dhe / ose teknika llogaritese dhe disa nivele referimi bazuar ne perceptimin dhe efektet e demshme indirekte te ekspozimeve ndaj fushave elektromafnetike (EMF). Madhesite qe rrjedhin janë Intensiteti i fushes elektrike (E), intensiteti e fushes magnetike (H), densiteti fluksit magnetik (B), Densitetit i fuqise (S), dhe rrymen e dobet (IL). Madhesite qe bazohen ne perceptimin dhe efekte te tjera te terthorta janë rryme e kontaktit (IC) dhe, për fushat e pulsante, energjia specifike e	E plote		

and other indirect effects are (contact) current (IC) and, for pulsed fields, specific energy absorption (SA). In any particular exposure situation, measured or calculated values of any of these quantities can be compared with the appropriate reference level.	perthithjes, (SA). Në ndonje situatë ekspozimi te vecante ,vlerat e matura apo te llogaritura te ndonjë prej këtyre madhesive mund të krahasohen me nivelin e pershtatshem te referimit.			
Respect of the reference level will ensure respect of the relevant basic restriction. If the measured value exceeds the reference level, it does not necessarily follow that the basic restriction will be exceeded. Under such circumstances, however, there is a need to establish whether there is respect of the basic restriction. Quantitative restrictions on static electric fields are not given in this recommendation. However, it is recommended that annoying perception of surface electric charges and spark discharges causing stress or annoyance should be avoided. Some quantities such as magnetic flux density (B) and power density (S) serve both as basic restrictions and reference levels, at certain frequencies (see Annexes II and III).	**Respektimi e nivelit të referencës do të sigurojë respektimin e kufizimit baze perkates.** Në qoftë se vlera e matur tejkalon nivelin e referencës, kjo nuk do të thote qe kufizimi bazë do të tejkalohet. Në rrethana të tilla, sidoqofte, eshte e nevojshme te vendoset si do te behet respektimi i kufizimeve baze. Kufizimet sasiore per fusha elektrike statike nuk janë dhënë në këtë rekomandim. Megjithatë, është e rekomandueshme se perceptimi i ngarkesave elektrike siperfaqesore dhe shkarkesat elekktrike qe shkaktojne stres apo bezdi duhet të shmangen. Disa madhesi të tilla si fluksi densitetit magnetik (B) dhe Densiteti i fuqise (S) sherbejne si kufizime baze dhe si nivele referencë per disa frekuenca të caktuara (shih Aneksin II dhe III	E plote		
ANNEX II **BASIC RESTRICTIONS** Depending on frequency, the following physical quantities (dosimetric/exposimetric quantities) are used to	**SHTOJCA 2** **KUFIZIMET BAZE** Në varësi të frekuencës, madhesite e mëposhtme fizike (madhesite dosimetrike / eksposimetrike) janë përdorur për të specifikuar kufizimet baze në fushat	E plote		

specify the basic restrictions on electromagnetic fields:	elektromagnetike:			
-between 0 and 1 Hz basic restrictions are provided for magnetic flux density for static magnetic fields (0 Hz) and current density for time-varying fields up to 1 Hz, in order to prevent effects on the cardiovascular and central nervous system,	- Midis 0 dhe 1 Hz kufizimet bazë janë dhene per densitetin e fluksit magnetik për fusha magnetike statike (0 Hz) dhe densitetin e rymes për fusha te ndryshueshme deri në 1 Hz, me qellim qe te parandaloje efektet ne sistemin nervor, qendror dhe kardiovaskular.	E plote		
- between 1 Hz and 10 MHz basic restrictions are provided for current density to prevent effects on nervous system functions,	-Midis 1 dhe 10 MHz kufizimet bazë janë dhene per densitetin e rymes për të parandaluar efektet në funksionet e sistemit nervor	E plote		
- between 100 kHz and 10 GHz basic restrictions on SAR are provided to prevent whole-body heat stress and excessive localised heating of tissues. In the range 100 kHz to 10 MHz, restrictions on both current density and SAR are provided,	- Midis 100 kHz dhe 10 GHz kufizimet baze për SAR-in janë dhënë për të parandaluar stresin nga nxehja e tere trupit dhe nxehjen e tepert te indeve te lokalizuara. Në diapazonin 100kHz deri në 10 MHz, jane dhene kufizimet per Densitetin e fuqise dhe SAR ,	E plote		
-between 10 GHz and 300 GHz basic restrictions on power density are provided to prevent heating in tissue at or near the body surface	-Midis 10 GHz dhe 300 GHz kufizimet baze për Densitetin e fuqise janë dhënë për të parandaluar nxehjen e indeve në ose prane lekures .	E plote		
The basic restrictions, given in Table 1, are set so as to account for uncertainties related to individual sensitivities, environmental conditions, and for the fact that the age and health status of members of the public vary.	Kufizimet bazë, dhënë në Tabelën 1, janë vendosur në mënyrë qe te marrin ne konsiderate ndjeshmërinë individuale, kushtet mjedisore, si dhe për faktin se mosha dhe gjendja shëndetësore publikut eshte e ndryshme	E plote		
Table 1	Tabela 1	E plote		

Basic restrictions for electric, magnetic and electromagnetic fields (0 Hz to 300 GHz) 0 Hz 40 . . . . . >0-1 Hz . 8 . . . . 1-4 Hz . 8/f . . . . 4-1 000 Hz . 2 . . . . 1 000 Hz-100 kHz . f/500 . . . . 100 kHz-10 MHz . f/500 0,08 2 4 . 10 MHz-10 GHz . . 0,08 2 4 . 10-300 GHz 10	Kufizimet Baze për fushat elektrike, magnetike dhe elektromagnetike (0Hz-300GHz) (0 Hz to 300 GHz) 0 Hz 40 . . . . . >0-1 Hz . 8 . . . . 1-4 Hz . 8/f . . . . 4-1 000 Hz . 2 . . . . 1 000 Hz-100 kHz . f/500 . . . . 100 kHz-10 MHz . f/500 0,08 2 4 . 10 MHz-10 GHz . . 0,08 2 4 . 10-300 GHz 10			
Notes: 1. . is the frequency in Hz.	**Shënime:** 1. *f* është frekuenca në Hz.	E plote		
2. The basic restriction on the current density is intended to protect against acute exposure .	2. Kufizimi bazë per densitetin e rymes ka për qëllim te mbroje kundër efekteve të ekspozimit	E plote		
3. Because of electrical inhomogeneity of the body, current densities should be averaged over a cross section of 1 cm2 perpendicular to the current direction.	3. Për shkak të johomogjenitetit elektrik të trupit, Densiteti i rymes duhet të mesatarizohet në një prerje siperfaqes 1 cm^2 pingul me drejtimin e levizjes rrymes.	E plote		
4. For frequencies up to 100 kHz, peak current density values can be obtained by multiplying the rms value by ã2 (=1,414). For pulses of duration tp the equivalent frequency to apply in the basic restrictions should be calculated as . = 1/(2tp).	4. Për frekuenca deri në 100 kHz, vlerat kulmore te Densitetit te rymes mund të merren duke shumëzuar vlerën RMS me $\sqrt{2}$ = (1,414). Për impulset me kohëzgjatje (tp) frekuenca ekuivalente qe aplikohet në kufizimet baze duhet të llogaritet si f = 1 / (2tp).	E plote		
5. For frequencies up to 100 kHz and for pulsed magnetic fields, the maximum current density associated with the pulses can be calculated	5. Për frekuenca deri në 100 kHz dhe për fusha magnetike pulsante , maksimumi i Densitetit te rymes qe shoqeron impulset mund të llogaritet nga rritja / renia e disahereshme dhe nga maksimumi i fuqise te	E plote		

from the rise/fall times and the maximum rate of change of magnetic flux density. The induced current density can then be compared with the appropriate basic restriction.	ndryshimit të densitetit të fluksit magnetik. Densiteti rrymes se induktuar mund të krahasohet me kufizimet e përshtatshme baze.			
6. All SAR values are to be averaged over any six-minute period	6. Të gjitha vlerat SAR jane mesatarizuar per ndonje periudhe gjashtë-minutëshe.	E plote		
ANNEX III **REFERENCE LEVELS** Reference levels of exposure are provided for the purpose of comparison with values of measured quantities. Respect of all recommended reference levels will ensure respect of basic restrictions. If the quantities of measured values are greater than the reference levels, it does not necessarily follow that the basic restrictions have been exceeded. In this case, an assessment should be made as to whether exposure levels are below the basic restrictions. The reference levels for limiting exposure are obtained from the basic restrictions for the condition of maximum coupling of the field to the exposed individual, thereby providing maximum protection. A summary of the reference levels is given in Tables 2 and 3. The reference levels are generally intended to be spatially averaged	**SHTOJCE III** **NIVELET E REFERENCES** Nivelet e referencës të ekspozimit janë dhënë me qëllim krahasimi me vlerat e madhësive të matura. Respektimi i të gjithe niveleve te rekomanduara te referencës do të sigurojë respektimin e kufizimeve bazë. Në qoftë se sasitë e vlerave e matura janë më të mëdha se nivelet e referencës, kjo nuk do të thote qe domosdoshmerisht kufizimet baze janë tejkaluar. Në këtë rast, duhet bere një vlerësim per te treguar qe nivelet e ekspozimit jane nen kufizimet bazë. Nivelet e referencës për ekspozimin kufizuar janë marrë nga kufizimet baze për kushtin e bashkveprimit maksimal te fushës me individin e ekspozuar, duke siguruar mbrojtje maksimale. Një përmbledhje e niveleve të referencës është dhënë në tabelat 2 dhe 3. Nivelet e referencës synojnë në përgjithësi të jene vlerat te mesatarizuara ne te gjithe trupin e individit te ekspozuar, por me kushtin e rëndësishem që kufizimet baze te lokale te ekspozimit nuk janë tejkaluar.	E plote		

values over the dimension of the body of the exposed individual, but with the important provision that the localised basic restrictions on exposure are not exceeded.				
Table 2 Reference levels for electric, magnetic and electromagnetic fields 0 Hz to 300 GHz, unperturbed rms values) 0-1 Hz — 3,2 × 104 4 × 104 — 1-8 Hz 10 000 3,2 × 104/f2 4 × 104/f2 — 8-25 Hz 10 000 4 000/f 5 000/f — 0,025-0,8 kHz 250/f 4/f 5/f — 0,8-3 kHz 250/f 5 6,25 — 3-150 kHz 87 5 6,25 — 0,15-1 MHz 87 0,73/f 0,92/f — 1-10 MHz 87/f1/2 0,73/f 0,92/f — 10-400 MHz 28 0,073 0,092 2 400-2 000 MHz 1,375 f1/2 0,0037 f1/2 0,0046 f1/2 f/200 2-300 GHz 61 0,16 0,20 10	**Tabela 2** Nivelet e references per fushat elektrike, magnetike dhe elektromagnetike (Vlerat e paperturbuara rms 0Hz deri 300GHz) 0-1 Hz — 3,2 × 104 4 × 104 — 1-8 Hz 10 000 3,2 × 104/f2 4 × 104/f2 — 8-25 Hz 10 000 4 000/f 5 000/f — 0,025-0,8 kHz 250/f 4/f 5/f — 0,8-3 kHz 250/f 5 6,25 — 3-150 kHz 87 5 6,25 — 0,15-1 MHz 87 0,73/f 0,92/f — 1-10 MHz 87/f1/2 0,73/f 0,92/f — 10-400 MHz 28 0,073 0,092 2 400-2 000 MHz 1,375 f1/2 0,0037 f1/2 0,0046 f1/2 f/200 2-300 GHz 61 0,16 0,20 10	E plote		
Notes:	**Shënime:**	E plote		
1. *f* as indicated in the frequency range column	1. *f* siç tregohet në shtyllën shkalla e frekuancave .	E plote		
2. For frequencies between 100 kHz and 10 GHz, Seq, E2, H2, and B2 are to be averaged over any six-minute period.	2. Për frekuenca midis 100 kHz dhe 10 GHz, S_{eq} , E^2, H^2, dhe B^2 do të mesatarizohet per cdo gjashte minuta	E plote		
3. For frequencies exceeding 10 GHz, Seq, E2, H2, and B2 are to	3. Për frekuenca më tepër se 10 GHz, S_{eq} , E^2, H^2, dhe B^2 do të mesatarizohet mbi çdo minute	E plote		

be averaged over any $68/f^{1.05}$ -minute period (f in GHz).	$68/f^{1.05}$ (f në GHz).			
4. No E-field value is provided for frequencies < 1 Hz, which are effectively static electric fields. For most people the annoying perception of surface electric charges will not occur at field strengths less than 25 kV/m. Spark discharges causing stress or annoyance should be avoided. Frequency range Maximum contact current (mA)	4. Asnje vlere e fushës elktrike nuk eshte dhene për frekuencat <1 Hz, të cilat janë efektivisht fushat elektrike statike. Për shumicën e njerëzve perceptimi i ngarkesave elektrike ne sipërfaqe nuk do të ndodhë në fusha me fortesi me te vogles se 25 kV/m. Shkarkesat qe shkaktojne stres ose bezdi duhet të eliminohen.	E plote		
Note: No higher reference levels on exposure to ELF fields are provided when exposures are of short duration (see Note 2 of Table 1). In many cases, where the measured values exceed the reference level, it does not necessarily follow that the basic restriction will be exceeded. Provided that adverse health impacts of indirect effects of exposure (such as microshocks) can be avoided, it is recognised that the general-public reference levels can be exceeded provided that the basic restriction on the current density is not surpassed. In many practical exposure situations external ELF fields at the reference levels will induce current densities in central nervous-system tissues that are below the basic restrictions. Also it is recognised that a number of	Shënim: Nuk jane dhene nivele reference më të larta në ekspozimin ndaj fushave ELF , kur ekspozimet janë me kohëzgjatje të shkurtër (Shënimi 2 i Tabeles 1). Në shumë raste, ku vlerat e matura tejkalojë nivelin e referencës, nuk do te thote qe kufizimet baze do te tejkalohen. Eshte vertetuar qe ndikimi e demshem ne shendet nga efektet indirekte te ekspozimit (të tilla si microshock) mund të shmangen, eshte e njohur se nivelet e referencës per publikun mund të tejkalohen duke vertetuar që kufizimet baze per densitetin e rrymes nuk jane tejkaluar. Në shumë situata praktike të ekspozimit te fushave ELF të jashtëme, në nivelet e referencës do të induktoje densitetin e rrymes në indet e sistemit nervor qendror, që janë nën kufizimet baze. Gjithashtu, dihet se nje numer pajisjesh lëshojnë fusha te lokalizuara qe i tejkalojne nivelet referencës. Sidoqofte, kjo zakonisht ndodh në kushtet e ekspozimit, ku kufizimet baze nuk janë tejkaluar për shkak të bashkeveprimit të dobët midis fushës dhe trupit.	E plote		

